



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:082986

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06221784

KPPP.nr. 477/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbaremore të kreditorit NT “Burimi VDD” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811328766 dhe seli në Ferizaj, Bibaj, kundër debitorit “Fresco Bazaar” Sh.P.K., me numër unik identifikues 81159177 dhe seli në Prishtinë, rr. “Vicianum”, p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Gent Spahija, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 82/2024, të datës 31.01.2024, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Besnik Aliu nga Ferizaj, jashtë seancës me datë 27.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Fresco Bazaar” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr. 82/2024 i datës 31.01.2024, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Besnik Aliu, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit NT “Burimi VDD” Sh.P.K., me datë 31.01.2024 ka lejuar urdhrin P.nr. 82/2024, duke lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit Faturës nr. 22-SHV01-FR-14856, e datës 30.05.2022; Faturës nr. 22-SHV01-FR-13973, e datës 24.05.2022 dhe Faturës nr. 22-SHV01-FR-10299, e datës 25.04.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën prej 801.07 EUR (tetëqind e një euro e shtatë cent), me kamatë ligjore prej 8 % nga data e kalimit të afatit për pagesë, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbarimor, me arsyetimin se dokumentet e besueshme, faturat e bashkangjitura në propozimin për përmbarim nuk janë të përshtatshme për përmbarim pasi që në to nuk është treguar koha e përmbushjes së detyrimit, siç përcaktohet me nenin 29, par. 3 të LPP-së. Ka shtuar se faturat të cilat janë lëshuar nga “N.T. Burimi – VDD”, me numër unik identifikues 811328766, ndërsa nga Regjistri i Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve vërtetohet se mban numrin unik identifikues 812046672. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet, si dhe të obligohet kreditori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përmbarimore në shumë prej 104.00 EUR.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigjen në prapësim.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 22-SHV01-FR-14856 e datës 30.05.2022; Fatura nr. 22-SHV01-FR-13973, e datës 24.05.2022 dhe Fatura nr. 22-SHV01-FR-10299, e datës 25.04.2022, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit në fatura, dhe të njëjtat i janë

bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit pasi që janë të përshtatshme për përmbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se në fatura nuk është treguar koha e përmbushjes së detyrimit mirëpo gjeti se pretendimet e tilla janë të pabazuara ngase në faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimi, secila prej tyre përmban datën e skadimit, e me të cilën datë debitori është pajtuar me vet faktin se ka pranuar faturat pa asnjë vërejtje apo kundërshtim. Ndërsa, në raport me pretendimin e debitorit se faturat janë lëshuar nga “N.T. Burimi – VDD”, me numër unik identifikues 811328766, ndërsa që në Regjistrin e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve debitori mban një numër unik identifikues tjetër, gjykata gjeti se numri identifikues i kreditorit në propozimin për përmbarim është identik me numrin identifikues të lëshuesit të faturës. Andaj, për gjykatën ky element është i mjaftueshëm për të vërtetuar faktin se faturat objekt i këtij përmbarimi janë lëshuar nga këtu pala propozuese ashtu që i njëjti, legjitimohet të kërkoj përmbarimin e faturave në këtë çështje përmbarimore.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 477/24, datë 27.09.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.